22636

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT TE TIRANES**
**Nr 22636 Akti**

**VENDIM**

**"MBI RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK"**

Sot, me date 18 /01/2000, une Gjyqtar N Dupp pasi u njoha me materialet e paraqitura nga kerkuesi Ismail Haroku, per te regjistruar si person juridik Shoqerine Tregtare "IMEL" Sh.p.k.

**KONSTATOVA**

Kerkuesi Ismail Haroku, shtetas shqiptar, biri i Ramazan-it, i dt. 1951 lindur e banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, ka themeluar Shoqerine Tregtare me pergjegjesi te kufizuar me ortak te vetem, me emertimin "IMEL Sh.p.k.".
Kjo Shoqeri ka Aktin e saj Themelues dhe Statutin e saj te dates / 01/2000. Ajo e ka seline ne Tirane, Rruga Durresit, autostrade. Ka nje afat veprimtarie te pakufizuar dhe mbi 10 vjet dhe nje kapital themeltar 100.000 leke (njeqindmije leke) i shlyer i gjithi nga Ortaku i Vetem i saj z. Ismail Haroku.
Shoqeria Tregtare "IMEL" Sh.p.k. ka objekt te veprimtarise se saj: prodhim e tregtim, me shumice e pakice i materialeve te ndertimit e mallrave te ndryshem; import-eksport.
Administrator i Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. eshte Ortaku i Vetem i saj Ismail Haroku.

Kerkesa e tij eshte e bazuar dhe si e tille duhet pranuar.

**P. K. A.**

Ne baze ligjit nr. 7638, date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe te ligjit nr. 7667, date 28/01/1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

**VENDOSA**

Regjistrimin si person juridik te Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. e Ortakut te Vetem Z. Ismail Haroku.
Kjo Shoqeri ka Aktin e saj Themelues dhe Statutin e saj te dates / 01/2000.
Ajo e ka seline ne Tirane, Rruga Durresit, autostrade. Ka nje afat veprimtarie te pakufizuar dhe mbi 10 vjet dhe nje kapital themeltar 100.000 leke (njeqindmije leke) i shlyer i gjithi nga Ortaku i Vetem i saj z. Ismail Haroku.
Shoqeria Tregtare "IMEL" Sh.p.k. ka objekt te veprimtarise se saj: prodhim e tregtim, me shumice e pakice i materialeve te ndertimit e mallrave te ndryshem; import-eksport.
Administrator i Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. eshte Ortaku i Vetem i saj Ismail Haroku.

Kunder ketij vendimi behet ankim brenda afatit ligjor.

GJYQTAR

Mirlmnda Deffo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 22636/1 Akti

VENDIM
" I GJYQTARIT TE VETEM "

Sot, me date 14/04/2003, une Gjyqtare M. Doffo, e gjykates se shkalles se Pare Tirane, pasi u njoha me materialet e paraqitura nga kerkuesi z. Ismail Haroku,

KONSTATOVA

Se Shoqeria tregtare "IMEL" sh.p.k., regjistruar si person juridik shqiptar me vendim gjykate nr. 22636 date 18/01/2000, me seli ne Tirane, me ortak te Vetem dhe Administrator z. Ismail Haroku, me kapital themeltar 100.000 leke i investuar ne masen 100% nga ortaku i vetem i saj, me kohezgjatje te veprimtarise ekonomike mbi 10 vjet, me objekt sipas pershkrimit te bere ne Statutin dhe Aktin e themelimit te shoqerise, ne Vendimin nr. 1 date 15/01/2003 te ortakut te vetem te kesaj shoqerie, ka vendosur shitjen e 50 kuotave te tij (50% te kapitalit themeltar) zj. Mimoza Kociu, sipas kontrates se shitblerjes se kuotave nenshkruar prej tyre me date 15.01.2003. Gjithashtu ne vendimin e ortakut te vetem eshte vendosur emerimi i zj. Mimoza Kociu drejtoreshe ekonomike e shoqerise IMEL shpk, si dhe pasqyrimi i ketij ndryshimi ne regjistrin tregtar te gjykates se Shkalles se Pare te Tiranes, duke bere depozitimin e ketij vendimi prane kesaj zyre.

Kerkesa e paraqitur nga kerkuesi cmoj se eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

P.K.A.

Ne baze te ligjit 7667 date 28/01/1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar nga shoqerite tregtare"

VENDOSA

Pranimin e kerkeses se paraqitur nga ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise tregtare "IMEL" shpk z. Ismail Haroku, per depozitimin e vendimit nr.1 date 15/01/2003 te kesaj shoqerie mbi shitjen 50% te kapitalit themeltar te shoqerise "Imel" shpk te zoteruar nga z. Haroku te perbere nga 50 kuota me vlere totale 50.000 leke zonjes Mimoza Kociu, sipas kontrates se shitblerjes se kuotave nenshkruar prej tyre, me date 15/01/2003, si dhe emerimin e kesaj te fundit Drejtoreshe ekonomike e shoqerise IMEL shpk.

Urdherimin e Zyres se Regjistrit Tregtar per te bere regjistrimin perkates ne kolonen___

Ndarjen e regjistrimeve nga njeri tjetri me vize te kuqe

Kunder vendimit lejohet ankim brenda afatit ligjor.

GJYQTARE
Majlinda Doffo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr 22636/2 Akti

VENDIM
" I GJYQTARIT TE VETEM "

Sot, me date 14/10 /2003, une Gjyqtare M. Doqe, e gjykates se shkalles se Pare Tirane, pasi u njoha me materialet e paraqitura nga kerkuesit ortaket e shoqerise" IMEL " dhe Administratorit te saj z. Ismail Haroku,

KONSTATOVA

Se Shoqeria tregtare "IMEL" sh.p.k., regjistruar si person juridik shqiptar me vendim gjykate nr. 22636 date 18/01/2000, me seli ne Tirane, me Administrator z. Ismail Haroku, me kapital themeltar 100.000 leke, me kohezgjatje te veprimtarise ekonomike mbi 10 vjet, me objekt sipas pershkrimit te bere ne Statutin dhe Aktin e themelimit te shoqerise, ne Vendimin nr.2 date 08/10/2003 te ortakeve te kesaj shoqerie, kane vendosur te shtimin e objektit te veprimtarise ekonomike te kesaj shoqerie perkatesisht si vijon : Veprimtari ekonomike ne fushen e ndertimit si dhe shitje te ndertesave civile, industriale, hoteleve etj, si dhe ambienteve te pershtatshme per dyqane, magazina, garazhe, zyra, etj, si dhe shitblerje te pasurive te palujtshme ne pergjithesi; projektim, investim dhe ndertim i veprave te zakonshme prej murature tulle, guri, druri, betoni, betonarmeje, metalike; kryerje transporti qe konsiderohet i nevojshem per permbushjen e aktivitetit te shoqerise; dhe pasqyrimi i ketij ndryshimi ne regjistrin tregtar te gjykates se Shkalles se Pare te Tiranes, duke bere depozitimin e ketij vendimi prane kesaj zyre.

Kerkesa e paraqitur cmoj se eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

P.K.A.

Ne baze te ligjit 7667 date 28/01/1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar nga shoqerite tregtare"

VENDOSA

Pranimin e kerkeses se paraqitur nga ortaket e shoqerise dhe nga administratori i shoqerise tregtare "IMEL" shpk z. Ismail Haroku, per depozitimin e vendimit nr.2 date 08/10/2003 te kesaj shoqerie mbi shtimin objektit te veprimtarise ekonomike te kesaj shoqerie perkatesisht si vijon : Veprimtari ekonomike ne fushen e ndertimit si dhe shitje te ndertesave civile, industriale, hoteleve etj, si dhe ambienteve te pershtatshme per dyqane, magazina, garazhe, zyra, etj, si dhe shitblerje te pasurive te palujtshme ne pergjithesi; projektim, investim dhe ndertim i veprave te zakonshme prej murature tulle, guri, druri, betoni, betonarmeje, metalike; kryerje transporti qe konsiderohet i nevojshem per permbushjen e aktivitetit te shoqerise ;

Urdherimin e Zyres se Regjistrit Tregtar per te bere regjistrimin perkates ne kolonen___

Ndarjen e regjistrimeve nga njeri tjetri me vize te kuqe

Kunder vendimit lejohet ankim brenda afatit ligjor.

GJYQTARE
Majlinda Doqe

Vendimi mbi regjistrimin

1/ Nr 22.636

2/ Emri Ismel ShPK.

3/ Selia: - Tirane Rruga Durrent Ankostuale

Objekti: prodhim tregtim me shumice e pakice materiale ndertimi te mallrave te ndryshme etj

5 Administrator: Ismail Hakobu, i cili formojnë, dhe 1951 lindur Korçe banon Tirane Rr. M. Gollesha Pall Ermesgjatekes Ap 10. Tirane, dhe ditak vetem

4/ Kohezgjatja nuk 10 vjet

Statuti - 6 flete

Akt themelimi - 4 flete

Dt vendosjes 17. 1. 2000

Dt regjistrimit 18. 1. 2000

Vleresim material per ortakun - 100000 lekesh

Nr 2 dt 17. 1. 2000



# AKT - THEMELIMI

# I

# SHOQERISE TREGTARE

# "IMEL " SH.P.K.

Ne mbeshtetje te Ligjit 7638 dt. 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit 7667 dt. 28/10/1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", personi privat, Ismail Haroku, shtetas shqiptar, , biri i Ramazan-it, i dt. 1951 lindur e banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, si themelues i Shoqerise Tregetare "IMEL" Sh.p.k., sot me date 17 / 01/2000, duke patur zotesine ligjore per te vepruar, vendosi per sa me poshte vijon:

**FORMIMI**
**Neni 1**

Formohet Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar e Ortakut te Vetem themelues Z. Ismail Haroku, me emertimin "IMEL" Sh.p.k.

**SELIA**
**Neni 2**

Shoqeria Tregtare "IMEL" Sh.p.k. e ka seline ne Tirane, Rruga Durresit, autostrade.

**KOHEZGJATJA**
**Neni 3**

Shoqeria Tregtare "IMEL" Sh.p.k. ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike te pakufizuar dhe mbi 10 vjet.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**
**Neni 4**

Objekti i veprimtarise ekonomike i Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. eshte prodhim e tregtim, me shumice e pakice i materialeve te ndertimit e mallrave te ndryshem; import-eksport.

**KAPITALI I SHOQERISE**
**Neni 5**

Kapitali themeltar i Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. eshte prej 100.000 leke (njeqindmije leke), i shlyer i gjithi nga Ortaku i Vetem Shoqerise.

**Neni 6**

Shoqeria Tregtare "IMEL" Sh.p.k. ka si Administrator te saj Z. Ismail Haroku.

**Neni 7**

Shoqeria ka vulen e saj zyrtare me permbajtje:
Shoqeria Tregtare "IMEL" Sh.p.k.

**BILANCI DHE TE ARDHURAT**
**Neni 8**

Viti financiar i Shoqerise mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.
Ne mbylljen e cdo viti financiar, Administratori i Shoqerise ben inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin.
Raporti i administrimit, iventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga Administratori, i nenshtrohen miratimit te Ortakut te Vetem brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

**Neni 9**

Ortaku i Vetem mund ti delegoje kompetencat e tij. Vendimet e tij evidencohen ne nje regjister.

**SHPERBERJA E SHOQERISE**
**Neni 10**

Shperberja e Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredolloj shkaku, duke vepruar sipas kritereve te parashikuara ne Statutin e Shoqerise.

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**
**Neni 11**

Ky Akt themelues (kontrate) perpilohet ne 4 kopje per:
- Gjykaten e Rrethit te Tiranes, per te bere veprimet ne Rregjistrin Tregtar dhe njohjen si person juridik te kesaj Shoqerie.
- Zyren e tatimeve per marrjen e certifikates se regjistrimit ne organin tatimor
- Dhomen e Noterise
- Nje kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k.

Akti firmoset rregullisht nga Ortaku i themelues i Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. Z. Ismail Haroku.

**ISMAIL HAROKU**

Tirane me 14/01/2000




# STATUTI

# I

# SHOQERISE TREGTARE

# "IMEL Sh.p.k."

**FORMIMI**
**Neni 1**

Formohet Shoqeria Tregtare me emertimin "IMEL" Sh.p.k., si shoqeri me pergjegjesi e kufizuar e Ortakut te Vetem themelues Ismail Haroku, shtetas shqiptar, biri i Ramazan-it, i dt. 1951 lindur e banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, sipas aktit themelues te dates 17/01/2000.

**SELIA**
**Neni 2**

Selia e Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. eshte ne Tirane, Rruga Durresit, autostrade.

**KOHEZGJATJA**
**Neni 3**

Shoqeria Tregtare "IMEL" Sh.p.k. ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike te pakufizuar dhe mbi 10 vjet.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**
**Neni 4**

Objekti i veprimtarise ekonomike i Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. prodhim e tregtim, me shumice e pakice i materialeve te ndertimit e mallrave te ndryshem; import-eksport.

## KAPITALI I SHOQERISE

### Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. eshte prej 100.000 leke (njeqindmije leke), i shlyer i gjithi nga Ortaku i Vetem Shoqerise.

### Neni 6

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane lirisht te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

### Neni 7

Shoqeria fiton zotesine juridike me rregjistrimin e saj ne Regjistrin Tregetar ne Gjykaten e Rrethit te Tiranes, si person juridik, ndersa e ushtron aktivitetin ekonomik me regjistrimin si subjekt privat ne Zyren e tatimeve.
Emertimi i Shoqerise, kapitali themeltar dhe emri i Administratorit te saj duhet te figurojne ne te gjitha dokumentet e nxjerra prej shoqerise dhe qe u drejtohen te treteve.

### Neni 8

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen Shoqeria Tregtare "IMEL" Sh.p.k.. Ajo ka llogari te saj ne leke dhe/ose valute ne bankat e Shqiperise.

### Neni 9

Ortaku i Vetem i Shoqerise i perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltar.

### Neni 10

Administratori i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht Ortakut te Vetem.

**Neni 11**

Administratori shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te Shoqerise.

**MARREDHENIET E PUNES**
**Neni 12**

Marredheniet e punes ne Shoqerine Tregtare "IMEL" Sh.p.k. rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtje qe nuk rregullohen me kontrate pune zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.
Shoqeria merr persiper qe te respektoje rregullat e ligjet ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore per te gjithe te punesuarit ne Shoqeri, ndersa keta te fundit jane te detyruar te pranojne kete Statut te Shoqerise.

**Neni 13**

Te punesuarit ne Shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe sipas Statutit per moszbatimin e detyrave te caktuara, si dhe per demet qe ata i shkaktojne Shoqerise. Ata mbajne pergjegjesi penale dhe administrative per moszbatimin e detyrave te tyre.

**Neni 14**

Mosmarreveshjet e te punesuareve me Shoqerine zgjidhen nga gjykata shqiptare, ne perputhje me percaktimet e bera ne kontraten e punes dhe ne zbatim te legjislacionit shqiptar ne fushen e punes.

**PERFAQESIMI I SHOQERISE**
**Neni 15**

Perfaqesimi i Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. i perket Z. Ismail Haroku dhe/ose personave te autorizuar prej tij.

**KONTROLLI I BRENDSHEM**
**Neni 16**

Shoqeria organizon kontrollin e brendshem me eksperte kontabel te autorizuar, sipas neneve 65 (ndryshuar me ligjin 7953 dt. 21.6.1995), 68, 69 te ligjit nr. 7638, dt. 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare".

## BILANCI DHE TE ARDHURAT
### Neni 17

Viti financiar i Shoqerise mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.
Ne mbylljen e cdo viti financiar, Administratori i Shoqerise ben inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin.
Raporti i administrimit, iventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga Administratori, i nenshtrohen miratimit te Ortakut te Vetem brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

### Neni 18

Ne seline e Shoqerise mbahet dokumentacion i plote i saj, dokument themeluese te Shoqerise, si dhe dokumentet qe rregullojne marredheniet ekonomike te Shoqerise, me te gjitha ndryshimet e bera deri ne ditet e fundit.

## SHPERBERJA E SHOQERISE
### Neni 19

Shperberja e Shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, si ne rast falimentimi, privimim i te drejtave re te ushtuar profesionin tregtar, forca madhore dhe cdo faktor tjeter qe nuk varet nga vullneti i Ortakut te Vetem te Shoqerise, por gjithmone me vendim te Ortakut te Vetem te Shoqerise si dhe ne baze te ligjes.
Ne keto raste Ortaku i Vetem i Shoqerise vendos mbi menyren e likujdimit te Shoqerise, duke caktuar nje ose me shume likuidatore dhe percakton detyrat e tyre.
Ne rast likuidimi te Shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeri ne likuidim e siper".
Ky shenim dhe emri i likuidusit ose i likuiduesve duhet te figurojne ne te gjitha aktet e dokumentat e nxjerra nga shoqeria dhe qe u drejtohen te treteve.
Likuidatoret dhe administratoret jane pergjegjes per veprimet e tyre dhe likuidimin e Shoqerise. Ata kujdesen per te likuiduar ne rradhe te pare detyrimet e Shoqerise ndaj te treteve.
Ortaku i Vetem ne fund te procesit te likuidimit vendos per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullueshmerise per administrimin nga ana e likuiduesit dhe per heqjen e mandatit te tij si likuidues si dhe per te evidencuar mbylljen e likuidimit.

Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likujdimit dhe kryhen formalitetet e nevojshme te likuidimit, Shoqeria c'regjistrohet nga Regjistri Tregtar i Gjykates se rrethit te Tiranes.

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**
**Neni 20**

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete Statut i referohet plotesimeve te bera nga Ortaku i Vetem i Shoqerise si dhe dispozitave te legjislacionit shqiptar.

**Neni 21**

Ky statut perpilohet ne kater kopje per:
- Gjykaten e rrethit te Tiranes per te bere veprimet ne Regjistrin Tregtar dhe njohjen si person juridik te kesa Shoqerie
- Zyren e tatimeve per marrjen e marrjen e certifikates se regjistrimit ne organin tatimor - Dhomen e Noterise
- nje kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te Shoqerise tregtare "IMEL" Sh.p.k.

**ORTAKU I VETEM SHOQERISE TREGTARE**
**"IMEL" Sh.p.k.**

**ISMAIL HAROKU**

Ismail Haroku

Tirane me 18/01/2000

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**Nr.** 110 **Rep**
**Nr.** **Kol**

## VERTETIM

Sot, me date 17 /01/2000 u paraqit personalisht para meje Noteres, Ismail Haroku, shtetas shqiptar, biri i Ramazan-it, i dt. 1951 lindur e banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, i panjohur prej meje, per identitetin e te cilit, une Noteria, u sigurova nga leternjoftimi i tij personal QH Nr. 329161 i cili deklaroi se akti i mesiperm eshte hartuar sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe nenshkroi rregullisht ne pranine time.

NOTERJA
Gyljere Pumina

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Regjistri i depozitimeve
Nr. 2

PULLE TAKSE
SHQIPERISE

VERTETIM

Sot, me date 17.01.2000, para meje Noteres Gjyltere Pustina, me seli ne Bulevardin Bajram Curri, u paraqit Ismail Haroku, shtetas shqiptar, lindur me 1951 e banues ne Tirane, rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjetikes, Ap.10, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i panjohur prej meje per identitetin e te cilit u sigurova nepermjet leternjoftimit te tij personal me nr. QH 329161 i cili kerkoi depozitimin prane kesaj zyre noterie te shumes prej 100.000 (njeqindmije) leke.
Une Noteria sot, me date 17.01.2000 mora ne dorezim shumen e lartepermendur te depozituar nga Ismail Haroku, si fond qe vjen nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar, per llogari te shoqerise "IMEL" shpk, ne formim e siper.
Ky depozitim eshte regjistruar ne rregjistrin e depozitimeve prane kesaj zyre me nr. 2, date 17.01.2000.
Per efekt te ligjes leshoj kete vertetim.

NOTERE
Gjyltere Pustina

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 111 Rep
Nr. 4 Kol

## VERTETIM

Sot, me date 17/01/2000 u paraqit personalisht para meje Noteres, Ismail Haroku, shtetas shqiptar, biri i Ramazan-it, i dt. 1951 lindur e banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, i panjohur prej meje, per identitetin e te cilit, une Noteria, u sigurova nga leternjoftimi i tij personal QH Nr. 329161 i cili deklaroi se akti i mesiperm eshte hartuar sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe nenshkroi rregullisht ne pranine time.

NOTERE
Gjyljana Kuka
[signature]

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**Nr.** 112 **Rep**
**Nr.** 5 **Kol**

## VERTETIM

Sot, me date 17/01/2000 u paraqit personalisht para meje Noteres, Ismail Haroku, shtetas shqiptar, biri i Ramazan-it, i dt. 1951 lindur e banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, i panjohur prej meje, per identitetin e te cilit, une Noteria, u sigurova nga leternjoftimi i tij personal QH Nr. 329161 i cili deklaroi se akti i mesiperm eshte hartuar sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe nenshkroi rregullisht ne pranine time.

NOTERE
Gjyljete Pushina

22636/L
15/04/2003

# KERKESE

| | |
|---|---|
| E : | z. Ismail Haroku, biri i Ramazan-it, i dt. 1951, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, |
| Obiekti : | Depozitim i vendimit nr.1 date 15.01.2003 i ortakut te vetem dhe Administratorit te shoqerise tregtare "Imel" shpk. |

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Shoqeria tregtare "IMEL" sh.p.k., regjistruar si person juridik shqiptar me vendim gjykate nr. 22636 date 18/01/2000, me seli ne Tirane, me ortak te Vetem dhe Administrator z. Ismail Haroku, me kapital themeltar 100.000 leke i investuar ne masen 100% nga une ortaku i vetem i saj, me kohezgjatje te veprimtarise ekonomike mbi 10 vjet, me objekt sipas pershkrimit te bere ne Statutin dhe Aktin e themelimit te shoqerise, mbeshtetur ne te drejten ligjore qe me jep pronesia mbi kete shoqeri, i kerkoj asaj gjykate si vijon : Depozitimin e vendimit te ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise "IMEL"shpk nr.1 date 15/01/2003, mbi shitjen e 50 % kuotave te shoqerise "Imel" shpk ose i 50% te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie zj. Mimoza Kociu, dhe emerimin e kesaj te fundit drejtoreshe ekonomike e shoqerise.
Te behen ndryshimet perkatese ne regjistrin tregtar te Gjykates se shkalles se pare Tirane.

Meqe kerkesa ime eshte e bazuar ne ligj, i lutemi asaj gjykate qe ta marre parasysh.

14/4/2003

KERKUESI
Administratori i
shoqerise "IMEL" shpk

Ismail Haroku

2

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIARNE
Nr. Rep. 673

VERTETIM

Sot, me date 08/04/2003 (dy mije e tre) para meje noteres Gjyltere Pustina, anetare e dhomes se noterise Tirane, me seli ne Tirane, Rr.Bul. Shqiperia e Re", u paraqit personalisht : z. Ismail Haroku, biri i Ramazan-it, i dt. 1951, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i cili me deklaron se ky vendim i ortakut te vetem te shoqerise "IMEL"shpk bashkangjitur eshte sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote dhe nenshkruan rregullisht para meje noteres. Une noterja vertetoj sa me siper sipas ligjit "Per noterine".

Notere
Gjyltere Pustina

SHOQERIA TREGTARE
"IMEL" shpk,
Regjistruar me Vendimi te Gjykates Tirane
nr. 22636 dt. 18/01/2000

VENDIM I I ORTAKUT TE VETEM
Nr.1 date 15/01/2003

Sot, me date 15/01/2003, une ortaku i vetem dhe Administratori i shoqerise tregtare "IMEL" shpk, me te drejten qe me jep pronesia mbi shoqerine ne masen 100%, si dhe ne baze te Akti – Themelues, Statutit te saj, dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi, per operativitetin e saj,

VENDOSA

1. Te pranoje si ortake ne shoqerine "Imel" shpk zj. Mimosa Kociu duke i shitur kesaj te fundit 50 kuota, barabarte me 50% te kapitalit themeltar te shoqerise "IMEL" shpk, kundrejt vleres se tyre nominale 1000 leke per kuote; si dhe te emeroje zj. Mimoza Kociu, drejtoreshe ekonomike te shoqerise "IMEL"shpk.

2. Te pasqyrohet sa me siper ne regjistrin tregtar te Gjykates se Shkalles se pare te Tiranes.

Ortaku i vetem dhe Administratori
i shoqerise "Imel" shpk
z. Ismail Haroku

Ismail Haroku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIARNE
Nr. Rep.673

VERTETIM

Sot, me date 08/04/2003 (dy mije e tre) para meje noteres Gjyltere Pustina, anetare e dhomes se noterise Tirane, me seli ne Tirane, Rr.Bul. Shqiperia e Re", u paraqit personalisht : z. Ismail Haroku, biri i Ramazan-it, i dt. 1951, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i cili me deklaron se ky vendim i ortakut te vetem te shoqerise "IMEL"shpk bashkangjitur eshte sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote dhe nenshkruan rregullisht para meje noteres. Une noterja vertetoj sa me siper sipas ligjit "Per noterine".

Notere
Gjyltere Pustina

KONTRATE SHITJE
(KUOTASH)

Sot, ne Tirane, me date 15.01.2003 (dy mije e tre), ne Tirane, lidhet kontrata e shitblerjes se kuotave ndermjet paleve kontraktuese si vijon :
**Shitesi :** SHOQERIA TREGTARE "IMEL" shpk, regjistruar me Vendim te Gjykates Tirane, nr. 22636 dt. 18/01/2000, perfaqesuar nga z. Ismail Haroku, biri i Ramazan-it, i dt. 1951, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine e ortakut te vetem dhe Administratorit te shoqerise tregtare "IMEL" shpk
Dhe
**Bleresi :** zj. Mimosa Kociu, shtetase shqiptare, e bija e Dushanit, banuese ne, Tirane, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, me pasaporte nr.
**Objekti** : *Shitje te Kuotave te Kapitalit themeltar te ortakut te vetem te shoqerise "IMEL" shpk ne masen 50%, perfshire ne 50 kuota, kundrejt vleres se tyre nominale 1000 leke per kuote.*

**Baza Ligjore** *:* Kodi Civil i RSh, neni 705, Ligji per Shoqerite tregtare, Akti Themelimit dhe Statuti i Shoqerise.

**Neni 1**
**Pronesia**

z. Ismail Haroku, rezulton te jete pronar e 100 kuotave ose i 100% te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare "T.E.S.-AL" shpk person juridik shqiptar, regjistruar me vendim te Gjykates se Tiranes nr. 22636, date 18/01/2000, ne baze te Statutit, Aktit te Themelimit dhe Vendimit te Gjykates se Tiranes per njohjen si Person Juridik te shoqerise T.E.S.-AL shpk dhe konfirmimit perkates e te azhornuar bere ne Zyren e Regjistrit tregtar te Gjykates se Tiranes.

**Neni 2**
**Cmimi**

Z. Ismail Haroku, (shitesi) deklaron dhe garanton se deshiron t'i shese e transferoje bleresit dhe bleresi deklaron e garanton se deshiron t'i bleje shitesit pasurine e luajtshme te llojit "Kuota te kapitalit themeltar" te shoqerise tregtare "T.E.S.-AL" shpk, te perbera prej 50 (pesedhjete) kuota, me nje vlere prej 1000 leke (nje mije) per Kuote. Shitesi deklaron se i shet bleresit ne teresi 50 kuota ose 50% dhe bleresi deklarohet se eshte dakort per te blere 50 kuota te kapitalit themeltar te shoqerise T.E.S.-AL shpk, me cmimin prej 1000 leke per kuote.

**Neni 3**
**Likujdimi ndermjet paleve**

Palet deklarojne se cmimi i pergjithshem i kuotave te shitura, i perbere prej 50 000 lekesh i eshte shlyer paraprakisht shitesit nga bleresi ne mase te plote dhe se ndermjet tyre nuk ka asnje detyrim tjeter financiar.
Nderkohe, pas nenshkrimit te kesaj kontrate shitblerje kuotash, bleresit i lind e drejta t'i kerkoje asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare "T.E.S.-AL" shpk te marre masat e nevojshme per pasqyrimin e ketij ndryshimi ne kapitalin themeltar te shoqerise, prane Regjistrit tregtar te Gjykates se Tiranes, ne nje kohe sa me te shpejte dhe marrjen e vendimit perkates nga Gjykata e Shkalles se Pare te tIranes lidhur me kete transferim.

**Neni 4**

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, shitesi z. Ismail Haroku humbet te drejten e pronesise mbi 50 kuotat e transferuara duke ruajtur te drejten e te qenurit ortak ne masen 50% ne shoqerine tregtare T.E.S.-AL shpk. ***Ndersa bleresi zj. Mimoza Kociu hyn ortake ne shoqerine TES-AL shpk duke zoteruar qe ketej e tutje 50 kuota ose 50% te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie.*** Si rrjedhim ortaku i ri i nenshtrohet te gjitha pergjegjesive/detyrimeve dhe te drejtave qe burojne nga te qenurit ortake e nje shoqerie tregtare, duke pranuar keshtu te gjitha klauzolat e akteve themeluese te shoqerise dhe duke vepruar ne te ardhmen ne unitet me ortaket e tjere per mbarevajtjen ekonomike te shoqerise.

**Neni 5**
**Hyrja ne Fuqi**

Kjo kontrate hyn ne fuqi diten e nenshkrimit te po kesaj kontrate.

**Neni 6**
**Te tjera**

Kjo kontrate shitblerje kuotash hartohet ne dy kopje origjinale, secila ne dy flete, me nga nje faqe, dhe pasi gjendet konform vullnetit te plote te paleve kontraktore firmoset rregullisht prej tyre.

Shitesi

Ismail Haroku

Bleresi

Mimoza Koçiu

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIARNE
Nr. Rep. 674

VERTETIM

Sot, me date08/04/2003 (dy mije e tre) para meje noteres Gjyltere Pustina, anetare e dhomes se noterise Tirane, me seli ne Tirane, Rr.Bul. Shqiperia e Re", u paraqit personalisht : z. Ismail Haroku, biri i Ramazan-it,
i dt. 1951, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, zj. Mimosa Kociu, shtetase shqiptare, e bija e Dushanit, banuese ne Tirane, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, me pasaporte nr. 0012827______, te cilet me deklarojne se kontrata e shitjes se kuotave bashkangjitur eshte sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote dhe nenshkruan rregullisht para meje noteres. Une noterja vertetoj sa me siper sipas ligjit "Per noterine".

Notere
Gjyltere Pustina

22636/2

# KERKESE

E : z. Ismail Haroku, biri i Ramazan-it, i dt. 1951, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, madhor, me zotesi te plote per te vepruar,

Obiekti : Depozitim i vendimit nr. 2 date 08.10.2003 asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare "Imel" shpk.

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Shoqeria tregtare "IMEL" sh.p.k., regjistruar si person juridik shqiptar me vendim gjykate nr. 22636 date 18/01/2000, me seli ne Tirane, me Administrator z. Ismail Haroku, me kapital themeltar 100.000 leke i investuar ne masen te barabarte nga te dy ortaket e shoqerise perkatesisht z. Ismail Haroku 50% dhe zj. Mimoza Kociu 50%, me kohezgjatje te veprimtarise ekonomike mbi 10 vjet, me objekt sipas pershkrimit te bere ne *Statutin dhe Aktin e themelimit te shoqerise, mbeshtetur ne te drejten ligjore* qe na jep pronesia mbi kete shoqeri, i kerkoj kesaj gjykate si vijon depozitimin e vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise "IMEL" shpk nr. 2, eshte vendosur te shtohet objekti i veprimtarise ekonomike te kesaj shoqerie perkatesisht si vijon : Veprimtari ekonomike ne fushen e ndertimit si dhe shitje te ndertesave civile, industriale, hoteleve etj, si dhe ambienteve te pershtatshme per dyqane, magazina, garazhe, zyra, etj, si dhe shitblerje te pasurive te paluajtshme ne pergjithesi; projektim investim dhe ndertim i veprave te zakonshme prej murature tulle, guri, druri, betoni, betonarmeje, metalike; kryerje transporti qe konsiderohet i nevojshem per permbushjen e aktivitetit te shoqerise;

Te behen ndryshimet perkatese ne regjistrin tregtar te Gjykates se shkalles se pare Tirane.

Meqe kerkesa jone eshte e bazuar ne ligj, i lutemi kesaj gjykate qe ta marre parasysh.

KERKUESI
Administratori i
shoqerise "IMEL" shpk
Ismail Haroku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIARNE
Nr. Rep. 2544

# VERTETIM

Sot, me date 08/10/2003 (dy mije e tre) para meje noteres Gjyltere Pustina, anetare e dhomes se noterise Tirane, me seli ne Tirane, Rr. "Bul. Shqiperia e Re", u paraqit personalisht : z. Ismail Haroku, biri i Ramazan-it, i dt. 1951, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i njohur prej meje noteres sipas ligjes, i cili me deklaron se kerkesa drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare te Tiranes, bashkangjitur eshte sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote dhe per kete nenshkruan rregullisht para meje noteres. Une noterja vertetoj sa me siper sipas ligjit "Per noterine".

Notere
Gjyltere Pustina

SHOQERIA TREGTARE
"IMEL" shpk,
Regjistruar me Vendimi te Gjykates Tirane
nr. 22636 dt. 18/01/2000

VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
Nr.2 date 08/10/2003

Sot, me date 08/10/2003 Asamblea e ortakeve e shoqerise tregtare "IMEL" shpk, ne baze te se drejtes qe na jep pronesia mbi shoqerine si dhe ne baze te Akti – Themelues, Statutit te saj, dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi, per operativitetin e saj,

VENDOSEM

1. Shtimin e objektit te veprimtarise ekonomike te kesaj shoqerie perkatesisht si vijon : Veprimtari ekonomike ne fushen e ndertimit si dhe shitje te ndertesave civile, industriale, hoteleve etj, si dhe ambienteve te pershtatshme per dyqane, magazina, garazhe, zyra, etj, si dhe shitblerje te pasurive te paluajtshme ne pergjithesi; projektim, investim dhe ndertim i veprave te zakonshme prej murature tulle, guri, druri, betoni, betonarmeje, metalike; kryerje transporti qe konsiderohet i nevojshem per permbushjen *e aktivitetit te shoqerise;*

2. Te pasqyrohet sa me siper ne regjistrin tregtar te Gjykates se Shkalles se pare te Tiranes.

Asamblea e ortakeve te shoqerise
"Imel" shpk

z. Ismail Haroku

zj. Mimoza Kociu

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIARNE
Nr. Rep. 2530

# VERTETIM

Sot, me date 08/10/2003 (dy mije e tre) para meje noteres Gjyltere Pustina, anetare e dhomes se noterise Tirane, me seli ne Tirane, Rr. "Bul. Shqiperia e Re", u paraqit personalisht : z. Ismail Haroku, biri i Ramazan-it, i dt. 1951, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, si dhe zj. Mimoza Kociu, e bija e Dushanit, lindur dhe banuese ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te njohur prej meje noteres sipas ligjes, te cilet me deklaron se kerkesa drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare te Tiranes, bashkangjitur eshte sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote dhe per kete nenshkruan rregullisht para meje noteres. Une noterja vertetoj sa me siper sipas ligjit "Per noterine".

Notere
Gjyltere Pustina

**KERKESE**

**E:** Ismail Haroku, shtetas shqiptar, , biri i Ramazan-it, i dt. 1951 lindur e banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10

**Objekti:** Per regjistrimin si Person Juridik te Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k.

GJYKATES SE RRETHIT TE TIRANES

22.636

TIRANE

Une i nenshkruari, Ismail Haroku, shtetas shqiptar, biri i Ramazan-it, i dt. 1951 lindur e banues ne Tirane, Rr. "Muhamet Gjollesha", Pll. Energjitikes, Ap. 10, ne baze te ligjit nr. 7638, date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe te ligjit nr. 7667, date 28/01/1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", kam themeluar Shoqerine Tregtare "IMEL" Sh.p.k., ndaj paraqes kerkesen time si me poshte vijon:

Shoqeria Tregtare "IMEL" Sh.p.k. ka Aktin e saj Themelues dhe Statutin e saj te dates 17 / 01/2000. Ajo e ka seline ne Tirane, Rruga Durresit, autostrade. Ka nje afat veprimtarie te pakufizuar dhe mbi 10 vjet dhe nje kapital themeltar 100.000 leke (njeqindmije leke) i shlyer i gjithi nga Ortaku i Vetem i saj z. Ismail Haroku.
Shoqeria Tregtare "IMEL" Sh.p.k. ka objekt te veprimtarise se saj: prodhim e tregtim, me shumice e pakice i materialeve te ndertimit e mallrave te ndryshem; import-eksport.
Administrator i Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. eshte Ortaku i Vetem i saj Ismail Haroku.

Meqenese si themelimi i Shoqerise Tregetare ashtu edhe objekti i veprimtarise se saj ekonomike mbeshteten ne ligj, i lutem Asaj Gjykate, pasi te shqyrtoje ligjshmerine e kesaj kerkese, te vendose per njohjen e Shoqerise Tregtare "IMEL" Sh.p.k. si person juridik dhe ta regjistroje ne regjistrin tregetar te gjykates.

**KERKUESI**

**ISMAIL HAROKU**